



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.948/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Rrustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren Edon Muçaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.948/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizren, Edon Muçaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizren paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, me të cilën ka kërkuar Rinumërimin e votave në Qendrën e Votimit 2020A, 2025A, 2021A, 2055A, 2048A, 2062A, 2005X, 2002A.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.948/2021, i ushtruar nga Edon Muçaj nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën ndër të tjera pretendon se në Qendrat e Votimit 2020A, 2025A, 2021A, 2055A, 2048A, 2062A, 2005X, 2002A, ka pasur parregullsi, pasi që ka pasur mospërputhje të rezultateve në formular, sepse sipas rezultateve të vëzhguesve, rezultoni se kanë më shumë vota se sa i ka publikuar KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Kandidati për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Edon Muçaj, kërkon korrigjimin e votave në vendvotimet e lartcekura, Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Edon Muçaj Kandidat për Kuvend Komunal nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje, Edon Muçaj, më të cilin apel kërkon që ti korrigjohen votat është i pa bazuar.


Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, nga formularët e bashkangjitur në apel nuk konstatohet ndonjë parregullsi në bartjen e votave ashtu siç pretendon ankuesi, gjithashtu i njëjti nuk ka bashkangjitur ndonjë deklaratë, të votuesve që dëshmojnë se kanë votuar për kandidatin në fjalë e që në të njëjtin vendvotim nuk i ka dalë asnjë vot, por vetëm thekson në mënyrë të përgjithshme se ka mungesë të votave në Qendrat e votimeve të lartcekura, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë bartjes së votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e saj nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë prove.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.948/2021 më datën 06.11.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaferi



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.